# DËSHMI ARKIVI

**A-450182**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi në kapitujt më të ndritur të historisë sonë kombëtare”, ish-presidenti Meidani: Në ç’emër flet kjo gjykatë kur populli i Kosovës proteston? |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/16/thaci-krasniqi-veseli-dhe-selimi-ne-kapitujt-me-te-ndritur-te-historise-sone-kombetare-ish-presidenti-meidani-ne-cemer-flet-kjo-gjykate-kur-populli-proteston-54/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 18:05:50 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 17:53:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 17:52:00 UTC → 16 shtator 2026, 17:54:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e52cf39e770e785cb24b1e26677c8538a962fd6b1d62cd420a39429588f2fdf1` |
| TEKSTI | `d2b74b70cbc6c740019e3cf47ed51676745a371d0a4f04e5cb8bcb5757cd7656` |
| PAMJA | `405b4a69fd992bc2d4370efb69525cd251a8fcd71b1e579281da4c55719b7a47` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d7c49479a70564c434ed34ebbc31da30ab1929c9dbfe559f55fa60df4b94a2d4` |
| E MËPARSHMJA | `679918c43ce2c8f95097ab19155801e242f8e91eff7ea7d19c7c0edb6b13a5c1` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d7c49479a70564c434ed34ebbc31da30ab1929c9dbfe559f55fa60df4b94a2d4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA DHE RAJONI | KRYESORE | TË FUNDIT

# "Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi në kapitujt më të ndritur të historisë sonë kombëtare", ish-presidenti Meidani: Në ç'emër flet kjo gjykatë kur populli i Kosovës proteston?

16/09/2026 19:53



**Ish-Presidenti i kohës së luftës së Kosovës, Rexhep Meidani, ka reaguar pas vendimit të Hagës, e cila dënoi me 81 vite burg 4 liderët e UÇK-së.**

Meidani u shpreh se asnjë gjyqtar i atij trupi gjykues nuk i përket Kosovës e nuk e kupton atë, duke shtuar se drejtësia e munguar duhet të jepet.

*"Kam qenë President i Republikës në vitet e vështira kur Shqipëria dhe populli i saj, hapën kufijtë dhe zemrën për vëllezërit e tyre shqiptarë të Kosovës që po dëboheshin nga shtëpitë dhe trojet e tyre nga milicët dhe paraushtarakët e regjimit represiv të Millosheviçit. E kam ndjerë këtë represion qysh prej viteve si pedagog i Universitetit të Prishtinës, sidomos në vitin 1981 e më pas kur jo vetëm nuk u lejuam për të vazhduar leksionet tona, por dhe na u bënë tepër të vështira kontaktet dhe komunikimet me studentët tanë. Si politikan dhe si Kryetar Shteti përjetova dhe shkallën më të lartë të egërsisë dhe represionit milloshevіçian ndaj popullit shqiptar të Kosovës, që kapi nivele të skajshme gjenocidale.*

*Aktgjykimi i sotëm në Hagë mban emrin e popullit të Kosovës, por asnjë gjyqtar i atij trupi gjykues nuk i përket Kosovës e nuk e kupton atë, dhe seanca nuk u mbajt as në tokën e saj. Kjo është pyetja që më mundon më shumë se vetë numri i tejzgjatur, pa arsye, i viteve. Në fakt, në ç' emër flet një gjykatë e tillë, kur populli që ajo pretendon ta përfaqësojë s'ka zë e peshë brenda saj, por proteston jashtë saj apo sheshet e Kosovës? Aktgjykimi është i shkallës së parë; procesi vazhdon. Drejtësia e munguar duhet të jepet! Por, ama, duhet ta përfaqësojë vullnetin e popullit të Kosovës, jo ta zhgënjejë atë"*, shprehet Meidani në reagimin e tij.

Më tej, ish-Presidenti i kohës së luftës së Kosovës u shpreh se ajo që nuk duhet të diskutohet është konteksti historik, duke theksuar se Kosova dhe populli i saj ishin viktimë e dhunës së shtetit serb, jo palë e barabartë me agresorin.

*"Ajo që nuk vazhdon të diskutohet është konteksti historik: Kosova dhe populli i saj ishin viktimë e dhunës së shtetit serb, jo palë e barabartë me agresorin. Përgjegjësia individuale, nëse do të kishte, assesi nuk mund ta relativizojë atë fakt, as të vërë në pikëpyetje lirinë dhe pavarësinë që Kosova i fitoi me çmim të jetëve njerëzore, veçanërisht të rinjve të saj. Këtë e kanë pranuar këto ditë, ashtu si dhe gjatë krizës kosovare, edhe mjaft zëra perëndimorë dhe kishin e kanë të drejtë.*

*Personalisht mendoj se asnjë vendim gjyqësor nuk mund t'ua heqë vendin që zënë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi në një nga kapitujt më të ndritur të historisë sonë kombëtare. Në atë kohë, kur liria e Kosovës dhe paqja e rajonit ishin ende një ideal pa siguri, ata guxuan të merrnin mbi supe barrën historike për ta sjellë lirinë te populli i tyre, në një moment kur çdo gjë rrezikohej e asnjë sukses nuk*


## Kryesore



Sot seancë plenare/ Pesë interpelanca në rend dite, Kuvendi vendos edhe për pagat e gjyqtarëve e prokurorëve
07:37

Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve
19:35

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!
19:10

"E respektojmë aktgjykimin e Dhomave të Specializuara"/ Reagon SHBA pas vendimit të Hagës: Të shmanget retorika nxitëse
15:47

"Topin e kam unë" së shpejti në Top Channel! Apliko tani në top-channel.tv
16:40

## Më të lexuarat

Dënimi me 81 vite burg i ish-liderëve të UÇK, Vuçiç del në konferencë dhe ankohet: Nuk janë dënuar për krime kundër njerëzimit

Nuk kënaqet me 81 vite burg për ish-krerët e UÇK, Prokurorja e Specializuar e Hagës: Do kërkojmë në Apel dënim edhe për krimet kundër njerëzimit

Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!

Ekskluzive/ "Jam i rënduar psikologjikisht, Thaçin tani do e kem më shumë mik", Majko i përlotur: Shqipëria e Kosova të shtrëngojnë dhëmbët dhe...

"Të respektohen vendimet e Hagës"/ Dënimi i liderëve të UÇK-së, Grenell i përgjigjet deklaratës së Marta Kos: Këto gjykata radikale duhet të mbyllen

Vuçiçit nuk i del inati/ 'Studion' reagimet e zyrtarëve të lartë të rajonit pas vendimit në Hagë, ndalet te Begaj e Rama, 'kërcënon' Malin e Zi

"Apeli nuk do të sjellë ndryshime"/ Vendimi

për liderët e UÇK-së, avokatja përlotet në 'Top Story': Edhe nëse 'Specialja' zhbëhet, nuk ka fuqi mbi dënimin e dhënë

Plagoset me armë zjarri avokati në Durrës, policia në kërkim të autorit, zbardhen emrat

Dënimi me burg për 4 liderët e UÇK-së, reagon komisionerja Marta Kos: Vendimet e Hagës duhet të respektohen

*ishte i garantuar. Unë e pashë atë rrezik nga afër, në kohën time si President, në pamjet e trishtueshme të dëbimeve me forcë dhe vrasjeve masive. Po ashtu, i kam njohur ata si djem, si luftëtar e udhëheqës trima, me emocionin rinor dhe gatishmërinë për sakrificë, dhe aspak si njerëz të aftë për veprimtari kriminale, që u përshkruhen sot"*, shkruan Meidani.

Më tej Meidani shton se Kuvendi i Kosovës ka detyrimin të vendosë që kjo gjykatë nuk meriton të vazhdojë të flasë në emër të një populli që, sipas tij, s'e njeh si të vetin.

*"Sot mendoj për këta katër burra dhe për familjet e tyre, që prej gati gjashtë vjetësh mbajnë peshën e këtij procesi, teksa vazhdojnë ende luftën dhe sakrificën e tyre për të garantuar një Kosovë të lirë. Jam pranë tyre, siç kam qenë e do të jem gjithmonë.*

*Shqipëria e zgjodhi rrugën perëndimore që në vitet e para të demokracisë, dhe unë e kam mbështetur atë zgjedhje si qytetar e President. Por besnikëria ndaj asaj rruge nuk kërkon heshtje kur diçka na duket e padrejtë. Kërkon që t'u kërkojmë aleatëve tanë Perëndimorë që t'u përmbahen, në çdo rast dhe për çdo popull, sado i vogël qoftë ai, parimeve mbi të cilat është ngritur demokracia, mbi të gjitha: liria, barazia dhe drejtësia për të gjithë, pa përjashtim.*

*Prandaj besoj se këto dënime duhet të kundërshtohen deri në shkallën e fundit, me çdo mjet ligjor në dispozicion. Madje, Kuvendi i Kosovës ka detyrimin të vendosë që kjo gjykatë, në formën e sotme, nuk meriton të vazhdojë të flasë në emër të një populli që s'e njeh si të vetin"*, përfundoi Meidani.

**Top Channel**

## Kosova dhe Rajoni »



Rita ora reagon pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së: Luftojmë për Kosovën, të cilën sot e quajmë shtëpi

17/09 09:06



Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së/ Tensione edhe gjatë natës në Prishtinë, protestuesit godasin me mjete piroteknike selinë e EULEX

17/09 08:55



"Liria ka emër", Dua Lipa reagon pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së: Askush nuk ka të drejtë ta njollosë luftën për liri

17/09 08:02



Vendimi i Gjykatës Speciale për ish-krerët e UÇK-së, reagon Daut Haradinaj: Deputetë duhet të ishin në seancë të jashtëzakonshme

17/09 07:50



Gjykata e Hagës dënoi me 25 vite burg Hashim Thaçin, reagon djali i ish-liderit të UÇK: Ne e dimë historinë, ushtarët tanë e kanë të gdhendur në lëkurë

16/09 22:52



Vuçiçit nuk i del inati/ 'Studion' reagimet e zyrtarëve të lartë të rajonit pas vendimit në Hagë, ndalet te Begaj e Rama, 'kërcënon' Malin e Zi

16/09 22:43

## Kryesore »



E rëndë në Tiranë/ 12-vjeçarja abuzohet seksualisht nga tezja dhe djali i hallës, në telefonin e të miturës u zbuluan video intime dhe…

17/09 09:09



Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së/ Tensione edhe gjatë natës në Prishtinë, protestuesit godasin me mjete piroteknike selinë e EULEX

17/09 08:55



Sherr me thika në Sarandë/ Plagosen tre persona, dy të arrestuar, një tjetër në kërkim

17/09 08:45









Operacion antidrogë në Korçë, në pranga 3 të rinj, sekuestrohen 6 kilogramë kanabis

17/09 08:41



Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së, Karamuço në 'Top Story': "Hambar" me spiunë që dëshmuan, një lojë e Serbisë

17/09 08:17



"Liria ka emër", Dua Lipa reagon pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së: Askush nuk ka të drejtë ta njollosë luftën për liri

17/09 08:02

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Dënimet në Hagë, Vuçiçit nuk i del inati me shqiptarët, kërcënon e shpërthen ndaj Ramës



Top Channel/ BE ndalon rrjetet sociale nën 13 vjeç: Mbrojmë fëmijët



Top Channel/ Durrës, plagoset avokati, një 61 vjeçar e qëlloi me armë zjarri



Top Channel/ Avokatët e Thacit & Co: Do ta apelojmë, vendim i paracaktuar



Top Channel/ Lot dhe protestë në Prishtinë e Hagë, Turma marshoi drejt EULEX-it



Top Channel/ Vuçiç në "sulm": Shqipëria fyeu gjykatën, preket integrimi



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.